



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Datë: 26.6.2023

Nr: 672

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**DHËNIEN E MANDATIT TË KRYETARIT TË BASHKISË KAMËZ, QARKU TIRANË, Z. RAKIP
BAJRAM SULI, TË PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E
SHQIPËRISË", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 26.6.2023, mora në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Dhënie e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, Qarku Tiranë, z. Rakip Bajram Suli, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, dhe neni 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

VËREJ:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Bazuar në nenin 166, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Kryetar bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse.

Datë: 26.6.2023 Nr: 672
Ora14:00



Për dhënie e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, Qarku Tiranë, z. Rakip Bajram Suli, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 536, datë 20.5.2023, ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për Kryetarin e Bashkisë dhe Këshillin e Bashkisë Kamëz.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me Vendimin nr. 636, datë 26.5.2023 ka korrigjuar gabimin material në vendimin nr. 536, datë 20.5.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar Bashkie dhe për Këshillin Bashkiak, zona zgjedhore Bashkia Kamëz, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023”.

Kundër vendimit nr. 536, datë 20.5.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, u administruan dy kërkesa ankimore:

Kërkesa ankimore nr. 81, datë 23.5.2023, me ankues subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe kërkesa ankimore nr. 86, datë 25.5.2023, me ankues subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit”, me objekt të përbashkët: Kundërshtimin e vendimit nr. 536, datë 20.5.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Kamëz, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

Subjekti zgjedhor “Bashkë Fitojmë”, kërkon gjithashtu pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore Bashkia Kamëz.

Subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit” kërkon rinumërim dhe rivlerësim të votave të vlefshme dhe të pavlefshme, në kutitë e votimit për këshill bashkiak në QV nr. 1575 dhe QV nr. 1597/02, si dhe ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatit e Këshillit Bashkiak Kamëz, duke përfshirë në të, rezultatit e dalë nga procesi i numërimit dhe vlerësimit të votave.

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në seancën e shqyrtimit, më datë 7.6.2023, ora 10:55, vendosi:

- 1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 81, datë 23.5.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”.*
- 2. Pranimin e kërkesës ankimore nr. 86, datë 25.05.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Partia Lëvizja e Legalitetit”*
- 3. Ndryshimin e vendimit nr. 536, datë 20.5.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Kamëz, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”, sipas Tabelës Përmbledhëse, të miratuar me vendimin e ndërmjetëm të KAS, të datës 1.6.2023.*

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim në Kolegj Zgjedhor Gjyqësor subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Datë: 26.6.2023 Nr: 672
Ora: 14:00



Për dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, Qarku Tiranë, z. Rakip Bajram Suli, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

Me vendimin nr. 30, datë 19.6.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi: rrëzimin e kërkesë padisë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, dhe nenin 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, Qarku Tiranë, z. Rakip Bajram Suli, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Datë: 26.6.2023 Nr: 672
Ora: 14:00



Për dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, Qarku Tiranë, z. Rakip Bajram Suli, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”